



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:100780

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05810665

**P.nr.29/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL** Sipas gjyqtarit Sabaheta Kurteshi, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Xharije Skenderi, në lëndën penale kundër të pandehurit **S. N. me numër personal..., nga fshati..., Komuna e Dragashit**, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren PP/II.nr.666-14/22 të datës 19.05.2022 në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 02.05.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Useinj Veli të pandehurit **S. N., të dëmtuarit E. B.**, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 03.06.2024 përpiloi, këtë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të akuzuarit:

**S. N.** i lindur më..., në fsh. B., me numër personal..., i biri i A. N. dhe nënës S. N., e gjinisë N., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, jo i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me dt. 03.04.2022, rreth orës 22:05 min, në fsh..., komuna e Dragashit, saktësisht në qendër të fshatit me qellim që ti shkaktoj lëndime trupore personit tjetër, e sulmon të dëmtuarin E. B., në atë mënyrë që i pandehuri në të dëmtuarin pas një mos marrëveshje që e kishin pasur më parë lidhur me një orë dore, të cilën ky i fundit pretendonte se i pandehuri para një viti ia kishte vjedhur, takohen rastësisht në rrugë dhe në ato momente i pandehuri i drejtohet të dëmtuarit me fjalët “kënd po e bënë ti hajdut bre, ta q... familjen” dhe pas këtyre fjalëve e godet të dëmtuarin me grusht në syrin e djathtë ku disa kalimtarë të rastit ndërhyjnë për ta ndaluar sulmin e mëtejshëm, me ç’rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, përkatësisht i shkakton ndrydhje të indeve të buta në regjionin për rreth syrit të djathtë, dëmtime të cilat janë shkaktuar si rezultat i veprimit mekanik të mjetit të fortë brejtës – jo të mprehtë, të përshkruara si në Akt ekspertimin mjeko-ligjor të dt. 24.04.2022.

**Këso dore i pandehuri ka kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 3, 4, 7, 17, 38, 39 par. 1 pika 1.1, neni 40 par. 1 pika 1.3, 43, neni 69, 70, 71, 72 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074, lidhur me nenin 364 të Kodit të procedurës penale, Kodi nr. 08/L-032, të akuzuarit i shqipton,

## **DENIMIN ME GJOBË**

Në shumën prej 500,00 (pesëqind) €, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nëse dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin brenda 3 muajve, i njëjti dënim do ti zëvendësohet me këtë Aktgjykim me dënim me burgim, duke e llogaritur 20 € për 1 ditë burgu, gjithsejtë 25 ditë burgu.

I dëmtuari: E. B. lidhur me realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të mendimit të ekspertit mjeko-ligjor sa ato do të bëhen, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 € dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

### **Pretendimet e palëve**

Prokuroria themelore ne Prizren pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr.666-14/22 të datës 19.05.2022, kundër të pandehurit S. N. nga fshati..., me numër personal..., për shkak te veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës duke me propozim qe gjykata pas administrimit te provave të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim të paraparë me ligj.

Gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 240 të KPP-ës, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 29.04.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit si dhe të akuzuarit. Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi ka udhëzuar të akuzuarin në bazë të nenit 241 par.1 të KPP-ës dhe pasi prokurori i shtetit ka lexuar aktin akuzues dhe pasi gjyqtarja u bind se i njëjti e ka kuptuar aktakuzën në bazë të nenit 242 si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të nenit 242 pika 1,2,3,4 të KPPK-ës, të njëjtit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

### **Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit**

I akuzuari me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë e pranoj fajësinë për veprën penale qe më ngarkohet kërkoj nga gjykata qe të merr parasysh këtë si rrethanë lehtësuese, më parë nuk kam qen i gjykuar, dhe më vjen keq qe ka ndodhë rasti si dhe nuk kemi pas ndonjë problem tjetër me palën e dëmtuar.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 242 par.2 të KPPK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit. Prokurori i Shtetit, me rastin e paraqitjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga akuzuarit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 241 të KPRK-së si dhe provat materiale dhe

faktet e çështjes, prandaj i propozoi gjykatës që të njëjtën ta shpallë fajtor dhe t'i shqiptojë sanksion penal në pajtim me ligjin.

### **Vlerësimi i pranimit të fajësisë**

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret si dhe materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: deklarata e të dëmtuarit e dhënë në polici me datë 03.04.2022, deklarata e të pandehurit e datës 03.04.2022 e dhënë në polici, Raporti i Oficerit me numër rasti 2022-GD-44 i datës 04.04.2022, raporti mjekësor lëshuar nga Qendra Emergjente në Dragash me numër protokolli rendor 4115, datës 03.04.2022, akt ekspertimi mjeko-ligjor Dr. N. U., datë 24.04.2022. Me qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari në bazë të nenit 242 paragrafit 2 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. Gjykata po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprën penale të akuzuarit dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij. Gjykata vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në diapozitivin e këtij aktgjykimi i akuzuari ka kryer veprën penale si më lartë.

Nga interpretimi dispozitës të nenin 185 arrihet në përfundimin se: ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik, të personit, cenimi i të cilit pas sjellë përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që të kenë prekur shëndetin e personit, konkretisht funksionimin normal të trupit të dëmtuarit, duke i sjellë dëmtime të përkohshme të shëndetit. Pos kësaj kjo vepër penale merr në mbrojtje jetën dhe trupin e njeriut. Në rastin konkret veprimet e dhunës fizike të ndërmarra nga i akuzuari ku i njëjti e godet të dëmtuarin me grusht në syrin e djathtë ....me ç'rast të dëmtuarit i shkaktonte lëndime të lehta trupore me pasojat të përkohshme për shëndetin, përkatësisht i shkaktonte ndrydhje të indeve të buta në regjionin për rreth syrit të djathtë, dëmtime të cilat janë shkaktuar si rezultat i veprimit mekanik të mjetit të fortë brejtës – jo të mprehtë, të përshkruara si në Akt ekspertimit mjeko-ligjor të dt. 24.04.2022, të cilat veprime kanë cenuar integritetin fizik, psike social e ekonomik të dëmtuarit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, rrethanë kjo cilësuese e veprës penale

### **Baza Ligjore**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70, 71 të KPRK-së, si rrethanë veçanërisht lehtësuese vlerësoi pranimin e fajësisë për veprën penale të kryer, e cila është bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin real dhe të sinqertë, mbajtës i familjes, kurse në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, ndërsa me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi intensitetin e rrezikimit apo i dëmtimit të së mirës së mbrojtur pasi që bëhet fjalë për vepër penale kundër jetës dhe trupit, ku me veprimet e tij i akuzuari i ka shkaktuar lëndime të lehta të dëmtuarit, siç është përshkruar në aktakuzë. Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, duke vlerësuar se edhe me dënimin me gjobe do të arrihet qëllimi i dënimit, Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të pandehurit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, andaj të njëjtit i shqiptoi dënimin ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi me gjobë i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e

kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryesit që do të shërbej në parandalimin të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së lidhur me nenin 461 të KPP-ës të KPP-ës Kodi nr. 08/L-032, pasi që nga të dhënat e mbledhura gjatë zhvillimit të procedurës nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të përsëritshëm.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore lidhur me paushallin gjyqësor është marr në kuptim të dispozitës nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPP-së Kodi nr. 08/L-032.

Vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit LIGJI NR. 08/L-109 PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE TË KRIMIT ( i plotësuar), neni 25 par 3 pika 1.3 i datës 02.11.2022 .

Në bazë të theksuarës më lartë u vendos si në diapozitivin e këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2022:100780, 02.05.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.